

STATUTI “SPACE TRAVEL” SHPK

STATUTI I SHOQRËISE ME PËRGJËGIESI TË KUFIZUAR “SPACE TRAVEL” SHPK

KREU 1

EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

Në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” me vullnet të lirë të plotë dhe të sinqertë, dhe iniciativën e lirë private, me cilesinë e ortakut të vetëm, sot më datë 09 prill 2021 shtetasit:

ELTON LESKAJ, shtetas shqiptar, lindur më 15.07.1992 në Tiranë, Shqiperi dhe resident në Tiranë në adresën Rr. Pandeli Cale, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar me kartë identiteti **J20715072L**

Në ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për qëndrën kombetare të regjistrimit” harton sot statutin e shoqërisë tregetare, me përgjegjësi të kufizuar të emertuar prej **“SPACE TRAVEL” SHPK**.

NENI 1

EMRI I SHOQËRISË

1. Emri I shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“SPACE TRAVEL” SHPK**

NENI 2

SELIA

- 2.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Tirane Tirane TIRANE Rruga "Pandeli Çale", Ndërtesa Nr.33, Hyrja 4, Ap.1, Njësia Administrative Nr.5, Tiranë.
- 2.2 Ortaku I vetëm / asambleja e shoqërisë, mund të krijojë seli të reja dyesore, madje të hapë filiale jashtë saj.

NENI 3

KOHËZGJATJA

3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti I veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Në fushën e veprimtarisë si operator turistik.

KREU 2

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

NENI 5

Kapitali themeltar I shoqërisë është:

Në para 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë, dhe është I ndarë në 1 (një) kuotë. Kapitali I shoqërisë zotërohet 100% nga ortaku I vetëm I shoqërisë, Zt. Elton Leskaj I identifikuar me kartë identiteti numër J20715072L.

Kapitali themeltar mund të zvogëlohet ose të rritet, mbi bazën e vendimit me shkrim që merr ortaku I vetëm / Asambleja e ortakëve, I cili nënshkruhet prej tij dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet në regjistrin përkatës.

NENI 6

Pjeset e kapitalit themelor, janë lirisht te transferueshme në rruge trashëgimie sipas dispozitave te kodit civil dhe atij tregëtar. Ortaku I vetëm / asambleja e ortakeve ka të drejtë të transferojë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht apo tërësisht kontributet e saj përfshirë dhe fondet e kontributet në natyrë.

NENI 8

ORGANET DREJTUESE

Ortaku I vetëm / Asambleja e Ortakëve është organi më I lartë drejtues dhe vendimor I shoqërisë dhe ai ushtron të gjithë kompentencat që ligji “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregetare” I njeh asamblesë së ortakëve. Ortaku I vetëm / Asambleja e ortakëve mund t’ ja delegojë kompetencat nje ose më shumë Administratorëve të caktuar prej saj ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë, vetëm mbi bazën e prokurës.

NENI 9

Me vendim të ortakut të vetëm / Asamblesë së ortakëve shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjera, shtetas shqiptare apo të huaj, ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregëtarë si Brenda dhe jashtë shtetit.

NENI 10

Ortakët e shoqërisë kanë këto të drejta dhe detyra kryesore:

1. Përcaktimi I politikave tregëtarë të shoqërisë;
2. Ndryshime të statutit
3. Miratimi I rregulloreve të brendëshme të shoqërisë si dhe ndryshimi I tyre
4. Emërimi dhe shkarkimi I administratorëve;
5. Emërimi dhe shkarkimi I likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar
6. Përcaktimi I shpërblimeve për personat e përmendur në pikat 4 dhe 7
7. Mbikqyrja e zbatimit të politikave tregëtarë nga administratorët, përfshi përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe I raporteve të ecurisë së aktivitetit
8. Miratimi I pasqyrave financiare vjetore dhe I raporteve të ecurisë së aktivitetit;
9. Shperndarja e fitimeve vjetore
10. Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar
11. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykimin ndaj organeve të administrimit
12. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
13. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj
14. Cështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti
15. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumentave përkatëse, së bashku me raportin e administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.
16. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku I vetëm / asambleja e ortakëve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në vecanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme
 - Miratimi I pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së aktivitetit
 - Shperndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi I humbjeve
 - Vendimet për investime

NENI 11

ADMINISTRATORI

Përfaqësimi I shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët si Brënda dhe jashtë shtetit si regull dhe përgjithësisht I përket administratorit. Administrator I shoqërisë është zgjedhur z. **Elton Leskaj**, për një periudhë 5 (pesë) – vjeçare nga data. 09.04.2021 deri 09.04.2026.

Administratori / ét, kanë të drejtë e detyrohen të:

1. Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të aktivitetit tregetar të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregetare të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. Përfaqësojnë shoqërinë tregetare
3. Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
4. Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së aktivitetit, dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesin keto dokumente përpara ortakut të vetëm / asamblesë së përgjithshme për miratim;
5. Krijojnë një sistem të paralajmërimit në kohën e duhur në lidhje me rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e aktivitetit dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin për qëndrën kombëtare të regjistrimit;
7. Raportojnë përpara ortakut të vetëm / asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregetare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rendesi të vecantë për aktivitetin e shoqërise tregetare;
8. Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
9. Administratorët janë të detyruar të thërasin dhe organizojnë mbledhjet e asamblese së përgjithshme.
10. Nëse ortaku I vetëm / asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkerisht shoqerine. Rregulloret e tjera te miratuara nga asambleja e përgjithshme mund te parashikojne ndryshe.
11. Ortaku I vetëm / asambleja e përgjithshme mund të shkarkojet administratorin në c' do kohë, me shumicë të zakonshme. Asnjë marreveshje nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë këtë të drejtë.
12. Në rastin e këshillit të administrimit, përfaqësuesi ligjor është administrator. Në rast se shoqëria funksionon me një administrator të vetëm atëherë administratori është përfaqësuesi ligjor I shoqërisë ndaj të tretëve.

NENI 12

Ky statut u reduktua në 4 ekzemplarë me përbajtje dhe vlera të njejta juridike, në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETËM

Elton Gjebrof 